VENDIM
Nr. 456, datë 27.5.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I AMFITEATRIT TË DURRËSIT"

(Ndryshuar me VKM nr. 743, datë 9.9.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të neneve 5, 44 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 13 e 17, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit", faza 2, miratuar me vendimin nr. 112/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "ndërtim", me një vlerë të përgjithshme prej *28 386 863 (njëzet e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh.*

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej *28 386 863 (njëzet e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh*, të përballohet, përkatësisht:

a) nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015, në shumën 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë.

b) nga fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2015, të Ministrisë së Kulturës, në shumën *14 386 863 (katërmbëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.*

5. Shpronësimi të fillojë në datën 27.5.2015.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Sipas kartelës së pasurisë", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministra e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Ndryshuar tabela me VKM nr. 743, datë 9.9.2015)

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA "PROJEKTI PËR REHABILITIMIN E HAPËSIRËS SË AMFITEATRIT TË DURRËSIT"

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m2)		Çmimi lekë/m²		Vlera lekë		SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Banese	
1	Skënder MYSHKETA	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	Sipas kartelës së pasurisë
2	Naxhie BYLYKBASHI	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	Sipas kartelës së pasurisë
3	Lutfie QOSJA	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	Sipas kartelës së pasurisë
4	Myrteza ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
5	Zyra BLLACA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
6	Besnik ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
7	Shekibe ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
8	Fatmir ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
9	Shpresa BASHA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
10	Abdulla ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
				336.40	**319.1**			**6,020,887**	**22,365,975**	**28,386,863**
	TOTALI : 28,386,863 lekë									